



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 583/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkritazi me ankesën e parashtruar nga Fidan Ramadani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Drenasit, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Drenas, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa parashtruara nga Fidan Ramadani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Drenas, me shenjën ZL.Anr.583/2017 e datës 09.11.2017, të parashtruar kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare nga KQZ më datë 08.11.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017, nga Fidan Ramadani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Drenasit, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Drenas, me të cilën pretendon se i janë dëmtuar votat në Venvotimet 0320E, 0302E, 0308E, informacioni paraprake që ka pasur ka qenë numër më i madh sesa votat që janë lajmruar nga elektorati.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës Fidan Ramadani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Drenasit, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës në ankesën e parashtruar nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet 0320E, 0302E, 0308E, në Drenas, si dhe në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimet në ankesën e parashtruar, në kuptim të nenit 117

par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: “*se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”. Paneli gjatë vendosjes për një ankesë i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në ankesë dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i ankesës, siç është në rastin konkret, ku parashtruesi i ankesës nuk e ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij, e refuzon ankesën si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.583/2017 më datën 10.11.2017.



***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*